

VENDIM
Nr.884, datë 22.12.2004

**PËR SHLYERJEN E DETYRIMEVE TË DISA NDËRMARRJEVE NDAJ KESH SHA-SË,
DHE INSTITUTIT TË SIGURIMEVE SHOQËRORE (ISSH)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10 e 14 të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2004", me propozimin e Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Industrisë dhe të Energjetikës në buxhetin e vitit 2004, t'i shtohet fondi prej 200 000 000 (dyqind milionë) lekësh, për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura të Kombinatit Energjetik, Elbasan, ndaj KESH sh.a.-së.

2. Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, në buxhetin e vitit 2004, t'i shtohet fondi prej 600 000 000 (gjashtëqind milionë) lekësh, për shlyerjen e detyrimeve të ndërmarrjeve të ujësjellësve si më poshtë vijon:

a) 300 000 000 (treqind milionë) lekë për shlyerjen e detyrimeve ndaj KESH sh.a.-së.

b) 300 000 000 (treqind milionë) lekë për detyrimet e prapambetura ndaj ISSH-së (Instituti të Sigurimeve Shoqërore).

3. Fondi prej 800 000 000 (tetëqind milionë) lekësh të përballohet si më poshtë vijon:

a) 400 000 000 (katërqind milionë) lekë nga fondi i kontingjencës i vitit 2004;

b) 400 000 000 (katërqind milionë) lekë nga subvencioni i planifikuar për importin e energjisë elektrike, të përdorur, për 6-mujorin e dytë.

4. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës, Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit, KESH sh.a. dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

**LISTA E SH.A. UJËSJELLËS KANALIZIME DEBITORE NDAJ KESH
SH.A. NGA 1.01.2004 DERI 31.11.2004**

Nr	Emertimi i sh.a.	Detyrimi 11 MUJOR 2004
1	Sh.a. ujesjelles Fushe Kruje	1633
2	Sh.a. ujesjellesi Kavaje	5219
3	Sh.a. ujesjellesi Patos	24574
4	Sh.a. ujesjellesi Ballsh	2417
5	Sh.a. ujesjellesi Vlore Qytet	45246
6	Sh.a. ujesjellesi Novosele	5102
7	Sh.a. ujesjellesi Selenice	4091
8	Sh.a. ujesjellesi Korce Qytet	3930
9	Sh.a. ujesjellesi Bilisht	3171
10	Sh.a. ujesjellesi Pogradec	10471
11	Sh.a. ujesjellesi Gramsh	191
12	Sh.a. ujesjelles Pegin	5072
13	Sh.a. ujesjellesi Elbasan Fshat	34761
14	Sh.a. ujesjellesi Elbasan Qytet	23522
15	Sh.a. ujesjellesi Berat	887
16	Sh.a. ujesjellesi Ura Vaigurore	2866
17	Sh.a. ujesjellesi Kucove	9561
18	Sh.a. ujesjellesi Corovode	4366
19	Sh.a. ujesjellesi Polican	2324
20	Sh.a. ujesjellesi Rrogozhina	1194
21	Sh.a. ujesjellesi Divjake	434
22	Sh.a. ujesjellesi Tropoje	4169
23	Sh.a. ujesjellesi Has	1306
24	Sh.a. ujesjellesi Lezhe	12595
25	Sh.a. ujesjellesi Shkoder Qytet	34298
26	Sh.a. ujesjellesi Shkoder Fshat	1700
27	Sh.a. ujesjellesi Vau Dejes	672
28	Sh.a. ujesjellesi Puke	1175
29	Sh.a. ujesjellesi Bulqize	634
30	Sh.a. Ujesjellesi Kraste	392
31	Sh.a. ujesjellesi Kurbin	15740
32	Sh.a. ujesjellesi Mirdite	2352
33	Nd ujesjellesit Gjrokaster Fshat	753
34	Sh.a. ujesjellesi Delvine	2620
35	Sh.a. ujesjellesi Permet	2913
36	Sh.a. ujesjellesi Tepelene	2561
37	Sh.a. ujesjellesi Sarande	9688
38	Sh.a. ujesjellesi Lushnje Qytet	12000
39	Sh.a. ujesjellesi Lushnje Fshat	3400
	TOTALI	300000

**LISTA E SH.A. UJËSJELLËS KANALIZIME DEBITORE NDAJ
INSTITUTIT TË SIGURIMEVE SHOQËRORE**

000/ leke

Nr	Emertimi i sh.a.	Detyrimi deri 30.11.2004
1	Sh.a. ujesjelles kanalizime Fushe Arrez	5245
2	Ndermarrja e ujesjellesit Vau Dejes	2246
3	Sh.a. ujesjellesi Shkoder Fshat	35349
4	Sh.a. ujesjellesi Malesi e Madhe	3714
5	Sh.a. ujesjellesi Puke	8428
6	Sh.a. ujesjellesi Sarande	12052
7	Sh.a. ujesjellesi Tropoje	9863
8	Sh.a. ujesjellesi Lezhe	12451
9	Sh.a. ujesjellesi Has	5307
10	Sh.a. ujesjellesi Kukes	9463
11	Sh.a. ujesjellesi Korce Fshat	20406
12	Sh.a. ujesjellesi Gjirokaster fshat	5144
13	Sh.a. ujesjellesi Gjirokaster Qytet	1552
14	Sh.a. ujesjellesi Permet	227
15	Sh.a. ujesjellesi Libohove	18
16	Sh.a. ujesjellesi Fier	9278
17	Sh.a. ujesjelles kanalizime Lushnje Qytet	22523
18	Ndermarrja ujesjellesit Divjake	682
19	Sh.a. ujesjellesi Elbasan fshat	47790
20	Sh.a. ujesjellesi Gramsh	7200
21	Sh.a. ujesjellesi Fushe Kruje	6674
22	Sh.a. ujesjellesi Kraste	2004
23	Sh.a. ujesjellesi Bulqize	5981
24	Sh.a. ujesjellesi Ura Vajguore	2609
25	Sh.a. ujesjellesi Kurbin	19000
26	Sh.a. ujesjellesi Skrapar	9912
27	Sh.a. ujesjellesi Vlore	34882
TOTALI		300000